

ELONA GJATA

Ë-JA E PATHEKSUAR TE BUZUKU DHE MATRËNGA

Vokalja *ë* e patheksuar përbën një interes të veçantë studimi në fushën e gjuhësisë shqiptare, pasi ajo mbetet një nga vokalet më problematike të shqipes, duke zënë dhe një vend të veçantë në studimet tona. Ajo mbetet dhe një nga pikat diferencuese ndërmjet dialekteve të shqipes.¹ Problematikën e saj do ta studiojmë në arbërishten e **Buzukut dhe Matrëngës**, në veprat monument të shqipes “Meshari” dhe “Embsuame e Kërshterë”, të shekullit XVI-të, shekull i cili do të shërbejë si zanafilla e shqipes së shkruar me Buzukun ndër shqiptarët veriorë dhe Matrëngën ndër shqiptarët jugorë.

Fillimisht do të nisim me veprën e Buzukut (1555), autori i librit të parë që hodhi themelet e “shqipes letrare”. Ai është konsideruar si gramatikani normativ i të së folmes shqiptare dhe lëvruesi i parë i shqipes letrare. Drejtshkrimi i Buzukut në këtë vepër na paraqet një shqipe të vjetër me një gjendje shumë të mirë konservuese.² Gjuha e tij paraqet qëndrueshmëri në trajtat fonetike dhe morfologjike, gjithashtu dhe një ortografi të ngulët. Vepra e Buzukut për shumë studiues, e sidomos për historianët e gjuhës, është konsideruar si një minierë të dhënash gjuhësore me vlera fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikologjike.

Duke qëndruar brenda këtij boshti kohor, por në skajin tjetër të shqipes, te vepra e jugorit Lekë Matrënga, “Embsuame e Kërshterë”, e cila është konsideruar si një vepër me vlera të veçanta, për vetë faktin se ajo na sjellë dëshmi të sistemit të toskërishtes jugore të gjysmës së dytë të shek. XVI, një sistem i cili ishte ruajtur në të folmen e izoluar të arbëreshëve të Hores në Sicili, ashtu siç ishte sjellë nga arbëreshet që erdhën nga bregu tjetër i Adriatikut. Ky fakt përfaqëson një realitet gjuhësor që paraprin pothuajse një shekull atë që përfaqësohet në veprën e Buzukut. Kjo vepër, edhe pse i përket dialektit jugor, na njeh edhe me disa trajta gjuhësore, morfologjike dhe fonetike, në veçanti të gegërishtes, gjë cila tregon një afritet të ndjeshëm të dialekteve të shqipes në atë periudhë se sa në gjendjen e sotme.³

Lekë Matrënga qëndron në pozita shumë të larta si drejtshkrues i gjuhës shqipe, madje duke u konsideruar si drejtshkrues shkencor i saj.⁴ Ai bëri me toskërishten atë që bëri Buzuku me gegërishten 37 vjet më para tij. Si Buzuku dhe Matrënga u shmangën nga veçoritë dialektore dhe u munduan të krijonin një shqipe të përbashkët.⁵ Pra, te këta autorë, veç të tjerash, vërehet një normë gjuhësore më e qëndrueshme, gjithashtu edhe më e zhvilluar.

¹ E. Çabej, *Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988, f. 307.

² S. Riza, *Vepra I*, Prishtinë, 1996, 273.

³ M. Mandala, *Njeriu, koha, vepra*, f. 120.

⁴ S. Riza, *Vepra I*, Prishtinë, 1996, f. 286.

⁵ S. Riza, *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f. 323.

Një nga tiparet e shqipes së vjetër është ruajtja e *ë*-së së patheksuar, e cila paraqitet si përfundim i reduksionit të një vokali të përparmë i patheks. Ky vokali përbën një syth të veçantë studimi me vlera fonetike. Gjendjen e *ë*-së së patheksuar do ta hasim pothuajse tek të gjithë autorët e vjetër të veriut, si dhe te jugori Lekë Matrënga. Ajo do të dalë në disa pozicione, qoftë para theksit, qoftë pas theksit. Grafika e zanores *ë* ka paraqitur një sërë problemesh nga Buzuku deri te Matrënga, pasi nuk kanë qenë në gjendje ta dallojnë grafikisht këtë zanore. I pari që tentoi për të dalluar grafikisht *ë*-në nga rrethi i autorëve të veriut ishte Bogdani megjithëse në mënyrë jokonsekuente, ai ka përdorur theksin e rëndë mbi grafemën /è/: *mbè Lametè Jebufejet; ndèr fa ligja Plaxè: pèr gni fi Adami mbèt giaaλ (gjej vet një shembull)*.⁶ Përdorimi i tingullit /è/ ashtu si në veprën e Buzukut edhe në veprat e lartpërmendura nuk përdoret për të shprehur zgjatimin, por për të shprehur vetë tingullin [è].⁷ Ajo është interpretuar fonetikisht si [e] ose [ë], kjo në bazë të përcaktimit të kriterëve që botuesit u kanë bërë veprave, por përcaktimi i këtyre kriterëve dhe interpretimi i tyre nuk ka qenë i njëjtë për studiues të ndryshëm. Kjo lidhet me shkallën e vështirësisë së interpretimit të kësaj zanoreje për shek. XVI-XVII.

Pavarësisht vlerës së saj fonetike si /e/ apo /ë/, në të shumtën e rasteve ajo del me vlerën e /ë/ në një numër të madh fjalësh, pasi pjesa më e madhe e fjalëve në këtë periudhë mbaron me këtë tingull, madje ajo ruhet më mirë në shqipen arkaike se sa në shqipen e sotme. Zanorja *ë* e patheksuar tek këta autorët del me natyrë konservative, pasi e gjejmë të ruajtur në trup të fjalës: ti neve *anëmikut* na ruoj, e madhe porsi *ushtëria*, përmbi *të dërejtëtë*, qi mbushi *zemërënë* e tī, *këjo* Antifenë, paçë *shpënesë* [Gj. Buzuku: Meshari]; të sosurit e sherbise çë *bënjënë* bri të krështerit, parakalesia e tinëzot ndë *kopështit*, ashtu si *vetëhenë* [L. Matrënga: Embsuame e Kërshterë], dhe në fund të saj, madje në fund të fjalëve proparoksitone, e cila është ruajtur me mjaft fanatizëm, në pajtim me gjuhën popullore: për jetë të *jetësë*, e jet përherë me Atët bekuom e me *shpirtinë* shenjtë, me ndërequnë *kambëtë* tonë mb udhë të paqës, me gjithë *zemërë* besojmë, defendo *popullinë* tand, na ndjefshim *ndihmënë* e tyne, ndiglo *oratënë* teme, Tënëzonë *nukë* e vunë përpara *faqesë* tyne, *afërë* anshtë atyne qi atë druonë, kondra *gluhësë* ngënjyeme, *shëgjetëtë* e d mujtunit janë fort të mprehuna, *u bafshinë veshëtë* e tū të ndigloume, *të vetëmë* Zot Krishtinë, mbë këtë *shekullë* plot me lot, me ngranë *bukënë* teme [Gj. Buzuku: Meshari]; çë bënë të tue vënë *dorënë*, pse *kluhenë*, klisha e shejtë katolikë e apostolikë e *Rromësë* e më parë atë çë *mbahetë* endë pistevot, çë *të vetëmë* zot tënë, të *trëtënë* ditë u ngre, të dimbëdhjetë pjesë të para të *besësë* sanë, *klishtësë* shejtë katolikë, *bukënë* tënë të përditëshmenë ëmëna sot e ndëljenja *mkatëtë* tona si ndëljenjëmë na atire, *të mirënë* tënë për shpirtit e për kurmit, edhe hīrrë e *ndihmënë* e saj, tīr sherbise *të parënë*, i truanj *kurminë*, e *shpirtinë të tretënë* i lipënj, të duash mirë *fqinjënë* ashtu si vetëhenë, mos zilepsnjësh *grëanë e fqinjësë*, mos zilepsnjësh *petkatë* e të

⁶ E. Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, botim kritik, Tiranë, 1968, f. 67.

⁷ S. Riza, *Vepra I*, Prishtinë, 1996, f. 269.

Ë-ja e patheksuar te Buzuku dhe Matrënga

tjerëvet, të gjegjësh **meshënë** ndë të krëmtet të urdheruame, të ruhesh mishit të mërkurë e **të prëmtënë** [L. Matrënga: Embsuame e Kërshterë]. Tek këta autorë, përveç ruajtjes së saj, bie në sy edhe përdorimi i shpeshtë i saj, saqë rrallëherë mund të gjesh ndonjë fjalëformë pa këtë tingull.⁸ Ajo është ruajtur qoftë në pozicion të brendshëm, qoftë në pozicion fundor, në fjalë të ndryshme me struktura të ndryshme rrokjesore në këtë periudhë kohore, në ndryshim me gjendjen e sotme, tingulli i cili ka rënë.

Atë e gjejmë të ruajtur dhe në fjalët ku theksi bie tri rrokje larg rrokjes fundore: me shelbuom gjithë **shekullinë**, qi mbushi **zemërënë**, defendo **popullinë** tand [Gj. Buzuku: Meshari]; të kallnjësh ndë botë **të vdekuritë**, **të ardhuritë** të shpërtit shejt, **të faluritë** kūr kle zënë i biri i tinëzot, mos kujto **emërinë** e tinëzot me lodrë, thuaj ti **urdhëritë** e tinëzot [Lekë Matrënga: Embsuame e Kërshterë].

Duke bërë një krahasim ndërmjet gjendjes së atëhershme dhe gjendjes së sotme të disa fjalëve do të konstatojmë rrëgjimin e **ë**-së së patheksuar, pothuajse në të gjitha pozicionet, gjë e cila ka shpënë dhe ndryshimin e strukturës rrokjesore të fjalës.

	Gjendja e atëhershme	Gjendja e sotme
Buzuku	anëmikut popullinë nukë arësye veshëtë e së drejtësë	armikut popullin nuk arsye veshët e së drejtës
Matrënga	fqinjësë pemëtë shpirtinë kurminë vetëmë bukënë	fqinjës pemët shpirtin kurmin vetëm bukën

Kjo zanore rezulton e ruajtur në të gjithë shkrimet e vjetra, në të dy dialektet e shqipes, ndërsa në fazën e mëvonshme ajo ra në gegërishte, ndërsa toskërishtja e ruajti duke e ruajtur trajtën e plotë të fjalëve, si p.sh. brinjë, fëmijë, mërqinjë, bijë, etj., kurse gegërishtja në pjesën më të madhe të fjalëve e ka humbur **ë**-n fundore të patheksuar, duke e kompensuar me gjatësinë e zanores së theksuar. Çabëj, përta i përket pozicionit të saj fundor, reduksionin e **ë**-së fundore të patheksuar e lidh me intensitetin e dobët të saj në krahasim me pozicionet e tjera, të cilit i pakësohet akoma më shumë rezistenca kur ka përpara saj një **t**-, pra në rrokjen fundore **–të**, ndërsa në rrokjet fundore që mbarojnë me **–në**, **–së**, **–rë**, **–më** ka rezistuar më mirë, dhe me ritmin e fjalisë. Zhdukja e **ë**-së fundore është e një kohe të re dhe mendohet se lidhet me rotacizmin, pasi qe kryer ai: shpënetkë > shpëntkë (shpëntkë).

Përta i përket kësaj zanoreje në lidhje me theksin e fjalës atë e gjejmë të ruajtur në pozicion protonik dhe posttonik, gjë që do të lindte nevojën e një

⁸ K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, Vep. I, SHBUSH, Luigj Gurakuqi, f. 191.

hulumtimi në tradita më të hershme të shkrimeve të shqipes, pasi këto vepra dëshmojnë për një formë më të mëdhe në lidhje me ruajtjen e [ë] në rrokjen para theksit.⁹ Në pozicion protonik: ti neve **anëmikut** na ruoj, **ndërequnë** kambëtë tonë mb udhë të paqesë, **këjo** Antifenë përposh thuhetë mbë kompletët, [Gj. Buzuku: Meshari]; në pozicion posttonik: zotynë ruon **shpirtinë** tand, defendo **popullinë** tand, kondra **gluhësë** ngënjyeme, ju qi ani **bukënë e dullyesë** [Gj. Buzuku: Meshari]; si ndë dhë **bukënë** tënë, **të mirënë** tënë, i truanj **kurminë**, mos zilepsnjësh **petkatë** e të tjerëvet, e **të klisëhë** [L. Matrënga: Embsuame e Kërshterë].

Pavarësisht të gjithave ajo do të ngelet brenda regjistrit të zanoreve të patheksuara. Ka raste që ajo trajtohet dhe si variant i detyrueshëm kontekstual i zanores **e**, madje në të folme të ndryshme nga ana nyjëtimore ajo ka kaluar në **e**. Nga aspekti nyjëtimor zanoret e patheksuara dalin më të labërguara se të theksuarat, ndoshta me këtë lidhet dhe shkalla e hapjes, pasi dalin më të hapura se zanoret e theksuara jo të shkurtra. Në lidhje me gjatësinë të patheksuarat fonetkisht janë më të afërta me të shkurtrat, pasi përfaqësojnë minimumin e tipareve të nevojshme që kufizon me ekstremin e përfaqësuar nga të shkurtrat.¹⁰ Duke u nisur nga efekti i dinamizmit të aksentit të shqipes në ruajtjen e plotësisë akustike dhe të gjatësisë së silabave, dhe nga reduksioni i vokales **ë** së patheksuar dhe zhdukjes së shpeshtë të saj, të cilat paraqesin një korrelacion mes tyre, shohim se kuantiteti dhe **ë**-ja e patheksuar qëndrojnë në përpjesëtim të zhdrejtë mes tyre. Kjo gjë na njeh me një zhvillim tjetër të gjuhës, pasi gegërishtja në të njëjtën kohë na paraqitet me një ruajtje të gjatësisë dhe me një zhdukje më të gjerë të **ë**-së patheksuar. Ndërsa në toskërishte shkalla e ruajtjes së këtij tingulli del më e madhe dhe me një humbje më të madhe të gjatësisë. Kështu karakteri centralizues i shqipes së vjetër ka marrë zhvillim më të madh në të folmet e gegërishte sesa në ato të toskërishtes. Pavarësisht kësaj, si nivelimi i ndryshimeve kuantitative apo apokopa e **ë**-së së patheksuar janë procese të reja fonetike.¹¹

Si konkluzion, nisur nga Buzuku deri te Matrënga, që përveç largësisë kohore, kemi dhe kapërcim nga njëri dialekt në tjetrin, në atë jugor, na paraqitet e njëjta situatë gjuhësore në lidhje me këtë tingull. Këto fakte të njëjta gjuhësore tek të dy autorët na tregojnë për një shqipe unitare në shek. XVI, gjë që sot ose ka mbetur në një zonë periferike ose mund të flitet për një asgjësim tejmbanë.¹² Natyra e tingullit /ë/ paraqitet mjaft e ndërlikuar dhe nuk mund të shpjegohet me një faktor të vetëm, pasi në përshkrimin e saj përfshihen shumë faktorë fonetikë, si rrethimi fonetik i saj, natyra e rrokjes, variantet dialektore, etj., pasi ajo paraqitet me një natyrë të paqëndrueshme, sidomos kur është në pozicion fundor dhe të patheksuar.

⁹ E. Çabej, *vep. e cit.* f. 277.

¹⁰ R. Ismajli, *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes*, në "Buzuku dhe gjuha e tij", Tiranë, 2005, f. 317.

¹¹ E. Çabej, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, në "Buzuku dhe gjuha e tij", Tiranë, 2005, f. 63.

¹² K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe, vep. I*, SHBUSH, Luigj Gurakuqi, f. 184.